



Përditësim për shtypin

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në gjykimin e Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Fadil Fazliut, Isni Kilajt dhe Hajredin Kuçit në lidhje me akuzat për ndikim të paligjshëm ndaj dëshmitarëve, më 25 shkurt 2026, Mbrojtja e Isni Kilajt dorëzoi dosjen paraprake të saj. Ajo u bë publike më 26 shkurt dhe gjendet në faqen e Dhomave të Specializuara në internet, së bashku me dosjet paraprake të dorëzuara më parë të Prokurorisë dhe ekipeve të tjera të Mbrojtjes.

Prokuroria pretendon se gjatë vizitave të ndara dhe të paprivileguara në objektin e paraburgimit, Hashim Thaçi u dha zotërinjve Smakaj, Kilaj, Fazliu dhe Kuçi informacion konfidencial për dëshmitarët e thirrur nga Prokuroria në çështjen gjyqësore Thaçi dhe të tjerët për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, i udhëzoi ata të ndikonin në dëshmitë e dëshmitarëve dhe u dha hollësi se si ta bënin këtë.

Të gjithë të akuzuarit në këtë çështje u vetëdeklaruan të pafajshëm për të gjitha akuzat.

Deklaratat hyrëse në këtë çështje u bënë më 27 shkurt, ku Prokuroria bëri deklaratën hyrëse të saj, ndjekur nga Mbrojtja e Bashkim Smakajt dhe Isni Kilajt. Sipas Rregullores, Mbrojtja mund të zgjedhë ta bëjë deklaratën hyrëse pas deklaratës hyrëse të Prokurores së Specializuar apo më vonë, pas përfundimit të paraqitjes së provave prej Prokurores së Specializuar, ose të mos bëjë deklaratë hyrëse. Videoincizimi i deklaratave hyrëse mund të gjendet në kanalën në YouTube të Dhomave të Specializuara.

Gjatë gjithë javës, Prokurorja e Specializuar paraqiti provat dhe argumentet e saj dhe tre dëshmitarë të thirrur prej Prokurorisë dhanë dëshmitë e tyre. Dëshmitari i parë dëshmoi nën masa mbrojtëse. Dëshmitari i dytë, Kun Herlar (Koen Herlaar), është punonjës i Institutit për Kriministikë të Holandës dhe dëshmoi në lidhje me prova konkrete të siguruar në këtë çështje. Dëshmitari i tretë, Kristofer Kelli (Christopher Kelly), është kontraktor me kohë të pjesshme i Prokurorisë që punon me hetimet e kriministikës digjitale. Mbrojtja u bëri pyetje si palë kundërshtare të tre dëshmitarëve.

Një pjesë e provave të paraqitura në këtë çështje janë incizime të bisedave të kryera gjatë vizitave të z. Thaçi në objektin e paraburgimit. Bazuar në vendimet e Gjykatës të Vetëm të disponueshme për publikun, mbikëqyrja dhe incizimet u kryen gjatë një periudhe të shkurtër kohe në vitin 2023. Ato u kryen vetëm në vizitat jo të privileguara, domethënë në vizitat nga miq dhe të njohur, dhe u autorizuan nga Gjykatësi i Vetëm si masë hetimore e posaçme. Arsyeja për urdhërimin e këtyre masave ishte dyshimi i bazuar për ndërhyrje të paligjshme ndaj dëshmitarëve.

Vizitat private me bashkëshortet dhe fëmijët dhe vizitat e privileguara nga mbrojtësit nuk ishin dhe nuk janë objekt i mbikëqyrjes apo incizimit.





Të martën, Gjykatësi i Vetëm lëshoi një urdhër gojor mbi kërkesën e Isni Kilajt, Bashkim Smakajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit për ndryshimin e disa kushteve të lirimit të përkohshëm të tyre. Gjykatësi u lejoi katër të akuzuarve të komunikojnë me njëri-tjetrin gjatë kohës që janë në mjediset e DHSK-së në Hagë, përfshirë në lidhje me çështjen e tyre, me kusht që në hapësirat publike të Gjykatës të mos diskutohen aspekte konfidenciale. Të gjitha aspektet e tjera të urdhrave të mëparshëm mbeten të pandryshuara.

Lidhur me hapat e mëtejshëm në këtë çështje, Gjykatësi i Vetëm bëri të ditur se Prokuroria pritet të mbyllë paraqitjen e provave më së voni deri më 18 mars. Mbrojtësja e pavarur që po kryen vlerësimin e disa prej provave për të siguruar që Prokurorisë të mos i jepet gabimisht asnjë informacion i privilegjuar ose privat, u urdhërua të dorëzojë raportin përfundimtar të saj deri më 13 mars. Ekipet e Mbrojtjes janë urdhëruar të njoftojnë gjykatën nëse kanë ndër mend të dorëzojnë kërkesë për hedhjen poshtë të akuzave deri më 19 mars dhe mocionin përkatës, nëse do të ketë, ta dorëzojnë më së voni deri më 25 mars 2026.

Në gjykimin e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit për akuzat për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, Mbrojtja e Kadri Veselit dorëzoi më 27 shkurt versionin e redaktuar publik të dosjes gjyqësore përfundimtare të saj, që fillimisht ishte dorëzuar si konfidenciale më 19 janar 2026. Parashtrimi i saj gjendet në faqen e internetit të Dhomave të Specializuara.

